



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 46/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit K..., me numër unik identifikues ....., me seli në Zonën Industriale Prishtinë – Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat G.C nga Prishtina, kundër të paditurit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të përgjigjes me nr. referencë 2/2 – 7018 e datës 27.12.2017, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 28.09.2022 në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar paditësit, me datë 06.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit K..., me të cilën ka kërkuar anulimin e përgjigjes nr. referencë 2/2 – 7018 e datës 27.12.2017 e nxjerrë nga i padituri Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe që të detyrohet i padituri që paditësit të ja njoh statusin e “Universitetit” me të gjitha të drejtat ligjore dhe të drejtën e përdorimit të emrit “Universitet”.

A r s y e t i m

Paditësi K..., ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e përgjigjes nr. referencë 2/2 – 7018 e datës 27.12.2017 të nxjerrë nga i padituri Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe ka kërkuar që paditësit ti njihet statusi i “Universitetit” me të gjitha të drejtat ligjore dhe e drejta e përdorimit të emrit “universitet”, me arsyetimin i padituri me datë 22.01.2007 fillimisht kishte licencuar Bartësi Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) A... me emrin “U...” licencë kjo e dhënë në kohë të pacaktuar dhe me vendimet nr. 589/02-1 të datës 09.05.2007 dhe vendimin nr. 1587/02-1 të datës 14.12.2007 ka licencuar fakultetet dhe departamentet në kuadër të U..., vendime këto të mbështetura në Ligjin nr. 2002/03 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë dhe UA nr. 14/2003 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë. Gjithashtu ka theksuar se me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, i padituri përmes Agjencisë Kosovare të Akreditimit ka lëshuar vendime për akreditimin e programeve duke emërtuar paditësin si

“K...”, ashtu që i është mohuar e drejta e fituar në vitin 2007 dhe se dispozitat e ligjit të ri është dashur të aplikohen vetëm ndaj institucioneve të reja, për çfarë pretendon se në këtë rast është bërë zbatimi i ligjit në mënyrë retroaktive. Po ashtu paditësi ka theksuar se “U...” asnjëherë nuk ka zbritur nën kriteret ligjore të cilat kanë qenë të nevojshme për ta fituar statusin e “universitetit” dhe të cilat edhe më tutje vlejné, ndërsa në anën tjetër ka licencuar si universitet qendrat në Prizren, Pejë, Gjiilan, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj vetëm për faktin se janë publike edhe pse të njëjtat nuk kanë plotësuar kriteret minimale për të fituar statutin e universitetit. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar në tërësi pranë padisë dhe parashtrësës për plotësimin dhe rregullimin e padisë, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet padia e paditësit ashtu që paditësit ti njihet statuti i Universitetit, statut ky i fituar në mënyrë të ligjshme në procedurë administrative.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se procedura e emërimit është e përcaktuar në nenin 10 par.4 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikës e Kosovës dhe sipas këtyre dispozitave fjala Universitet si fjalë e ndarë ose në kombinim me përshkrime të tjera nuk mund të miratohet ose të përdoret në çfarëdo forme në emërtimin e ndonjë bartësi pa lejen e Ministrisë pas miratimit në parim nga ana e Agjencia e Kosovës për Akreditim. Po ashtu ka theksuar se në pikën 1 të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/73 të datës 07.07.2009 asnjë bartës privat i arsimit të lartë (BPrAL) në Republikën e Kosovës, nuk mund të bartë emrin Universitet, të jep tituj akademik për mësimdhënës apo të ofroj studime të doktoratës, ashtu që ka pretenduar se në bazë të këtij vendimi të paditurës MASHT i mungon legjitimiteti pasiv në këtë kontest. I padituri nuk ka prezantuar në seancën e caktuar për datën 28.09.2022, andaj gjykata e ka mbajtur seancën në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të paditurit pasi që i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim nr.33/02-5, i datës 22.01.2007, Vendim nr.589/02-1 i datës 09.05.2007, Vendim 1587/02-1 i datës 14.12.2007, Certifikatë e Akreditimit për periudhën 01.10.2009 - 30.09.2010, Certifikatë e akreditimit për periudhën 01.10.2010 - 30.09.2011, Vendim nr.464/12 i datës 09.07.2012, Vendim 515/13 dt.08.07.2013, Përgjigje në kërkesë nr.10/1214, dt.15.03.2012, Letër distribuomi nr.363 dt.24.08.2016, Urdhërues për përdorimin e drejtë të emërimit të institucionit nr. 10/2936 e datës 20.07.2012, Kërkesë për zbatimin e ligjshmërisë nr.2844 e datës 03.06.2013, Kërkesë për vendosje në lidhje me kërkesën nr. 2844 të datës 03.06.2013, Aktgjykim A.nr.991/13 të datës 13.02.2017 i Gjykatës Themelore

në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, Aktgjykim AAnr.156/17, i datës 20.10.2017 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Përgjigje në kërkesën me nr. 7018 e datës 19.12.2017, Vendim i Qeverisë së Kosovës nr.01/73 dt.07.07.2009, Përsëritje e kërkesës për të vendosur nr.7018 e datës 19.12.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

Gjykata konstaton se paditësi fillimisht me datë 03.06.2013 kishte parashtruar kërkesën nr. prot. 2844 tek i padituri me të cilën kishte kërkuar që të i njihet statuti i universitetit sipas vendimit nr. 33/02-5 të datës 22.01.2007 të MASHT. Pasi që i padituri nuk kishte vepruar sipas kërkesës së datës 03.06.2013, paditësi kishte parashtruar kërkesë të përsëritur me datë 10.07.2013. Pasi që i padituri nuk ishte përgjigjur as në kërkesën e dytë, paditësi kishte parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr. 991/13 të datës 13.02.2017 kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe kishte detyruar të paditurin që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktgjyimit të merr vendim sipas ankesës së paditësit të protokolluar me nr. 2844 e datës 03.06.2013. Ky aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin AA.nr. 156/2017 të datës 20.10.2017.

Paditësi me datë 19.12.2017 kishte parashtruar kërkesën nr. prot. 7018 me të cilën kishte kërkuar zbatimin e aktgjyimit të plotfuqishëm të gjykatës. I padituri me Përgjigje nr. prot. 2/2 – 7018 të datës 27.12.2017 ka theksuar se sipas nenit 4 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, emërtimi “Universitet” paraprakisht duhet të miratohet në parim nga ana e Agjencia Kosovare e Akreditimit, duke pasur parasysh plotësimin e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe pastaj mund të miratohet nga MASHT. Gjithashtu ka theksuar se me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/134 të datës 14.07.2010, Kolegji AAB është ri akredituar me programe të studimit me emërtimin “A... – R...”, prandaj ndërrimit i emërtimit mund të bëhet vetëm konform legjislacionit të fuqi. Kundër Përgjigjes nr. 2/2 – 7018 të datës 27.12.2017 të MASHT, paditësi ka parashtruar padi.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”* dhe në kuptim të nenit 13 par. 2 i cili përcakton: *“Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.*

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ pasi që ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga prova Vendim nr.33/02-5, i datës 22.01.2007, gjykata konstatoi se Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka aprovuar ankesën e BPrAL Arena e Arteve Bashkëkohore - AAB, dhe është licencuar me emër U... A..., kjo në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 2002/3 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 14/2003 të datës 17.07.2003.

Nga prova Vendim nr.589/02-1 i datës 09.05.2007, gjykata konstatoi se sipas kërkesës së BPrAL Universiteti AAB, MASHT ka vlerësuar se i njëjti ka plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 2002/3 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 14/2003 të datës 17.07.2003 për zhvillimin e procesit mësimor dhe shkencor në nivelin 5 sipas ISCED dhe i ka vazhduar licencën dhe e ka ri licencuar për departamentet të përshkruara në vendim në pikat 1, 2 dhe 3, ndërsa në pikën 4 ka përcaktuar se kohëzgjatja e licencës për (ri) licencim është 3 (tri) vite (2006/2009).

Nga prova Vendim 1587/02-1 i datës 14.12.2007, gjykata konstatoi se sipas kërkesës së BPrAL Universiteti AAB, MASHT ka vlerësuar se i njëjti ka plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 2002/3 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 14/2003 të datës 17.07.2003 për zhvillimin e procesit mësimor dhe shkencor në nivelin 5 dhe 6 sipas ISCED dhe i ka vazhduar licencën dhe e ka ri licencuar për departamentet të përshkruara në vendim në pikat 1 dhe 2 ndërsa në pikën 3 ka përcaktuar se kohëzgjatja e licencës dhe (ri)licencimi është 5 (pesë) vite (2006/2011).

Nga provat Certifikatë e Akreditimit për periudhën 01.10.2009 - 30.09.2010 dhe Certifikatë e akreditimit për periudhën 01.10.2010 - 30.09.2011, gjykata konstaton se paditësi është akredituar nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës si “A... – R...” për periudhat 01.10.2009 deri 30.09.2010, 01.10.2010 – 30.09.2011 dhe 01.10.2010 – 30.09.2013.

Nga prova Vendim nr.464/12 i datës 09.07.2012, gjykata konstaton se paditësit Kolegji AAB i janë akredituar programet e studimit nga Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim për periudhat 3, 2 dhe 1 vjeçare, kjo në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.

Nga prova Vendim 515/13 dt.08.07.2013, gjykata konstaton se Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka ri akredituar A... në nivel institucional për një periudhë prej 5 viteve (1 tetor 2013 – 30 shtator 2018).

Nga prova Përgjigje në kërkesë nr.10/1214, dt.15.03.2012, gjykata konstaton se i padituri në përgjigje të kërkesës së paditësit ka theksuar se Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nuk ka asnjë kufizim për BPrAL, të cilët kanë qenë të akredituar dhe licencuar për programet, të cilat kanë përgatitur kuadro edhe për mësimdhënie dhe ligji nuk ka fuqi retroaktive dhe nuk i përfshinë studentët e regjistruar në programet e akredituara dhe licencuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, ashtu që studentët e regjistruar në këto programe para se të hyj në fuqi ky ligj, vazhdojnë deri në përfundim të studimeve.

Nga prova Letër distribuimi nr. 363 dt.24.08.2016 gjykata ka konstatuar se nga mbledhja e mbajtur me datë 22.08.2016 në mes të udhëheqësve të SIA-ve, kanë dal dy konkluzione: “a) *Të gjithë mësimdhënësit aktual të cilët gjenden në proces arsimor që posedojnë diploma në programet e licencuara dhe të akredituara të BPrAL-ve, vazhdojnë të punojnë kurse konkurset eventuale për këto pozita anulohen dhe b) Gjatë rekrutimit të stafit të ri kandidatët që posedojnë diploma nga programet studimore të BPrAL që licencimin dhe akreditimin e parë e kanë para hyrjes në fuqi të ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-137, trajtohen të barabartë me të diplomuarit në universitetet publike.”*

Nga prova Urdhërues për përdorimin e drejtë të emërimit të institucionit nr. 10/2936 e datës 20.07.2012, gjykata ka konstatuar se i padituri i ka njoftuar të gjithë BPrAL se janë të obliguar ligjërisht që ta përdorin drejt dhe korrekt emërtimin e institucionit, në harmoni me vendimin e lëshuar nga MASHT dhe Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur nuk ka aprovuar kërkesën e paditësit që të njëjtit ti lejohet përdorimi i emërimit “Universitet” dhe ushtrimin e të drejtave ligjore që ka një universitet.

Nga pretendimet e paraqitura më lartë, gjykata vlerëson se paditësi të drejtën e tij për të ju lejuar përdorimi i emërimit “Universitet” dhe të drejtave ligjore që ka një universitet e

mbështet kryesisht në Vendim nr.33/02-5, i datës 22.01.2007, Ligjin Nr. 2002/3 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë dhe Udhëzimin Administrativ nr. 14/2003 të datës 17.07.2003 me arsyetimin se ligji i ri - Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nuk mund të ketë efekt retroaktiv ashtu që paditësi duhet të vazhdojë të gëzojë të drejtën që e ka fituar paraprakisht me vendimin e lartcekur.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë të pretendimeve të paditësit, gjykata konstaton se çështja akreditimit dhe licencimit të bartësve të institucioneve private të arsimit të lartë për periudhën kontestuese fillimisht është rregulluar fillimisht me Ligjin Nr. 2002/3 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë i cili ka qenë në fuqi deri me datë 25.09.2011, kur ka hyrë në fuqi Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës. Me nenin 37 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës është përcaktuar se: *“Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji 2002/03 mbi arsimin e lartë dhe çdo dispozitë ligjore e cila është në kundërshtim me këtë ligj.”*

Nga provat e administruara në këtë çështje, gjykata vlerëson se me Vendimin nr.33/02-5, të datës 22.01.2007, Vendimin nr.589/02-1 të datës 09.05.2007 dhe Vendimin 1587/02-1 të datës 14.12.2007 paditësi është licencuar dhe ri licencuar si U..., për periudha të ndryshme e që përfshijnë vitet akademike 2006 deri 2011 kjo në përputhje me Ligjin Nr. 2002/3 mbi Arsimin e Lartë në Kosovë ndwrsa nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës është akredituar si “A... – R...”.

Për vlerësimin e pretendimeve të paditësit për zbatimin e ligjit në mënyrë retroaktive gjykata ju referua nenit 3, par.1, pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës i cili përcakton se: *“1.1. Akreditim - njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranuar të cilësisë dhe se kualifikimet e tij u japin bartësve të tyre, në pajtim me ligjin në fuqi, një numër të drejtash, siç janë mundësia për qasje në një nivel të mëtejshëm arsimor, profesione specifike dhe për të përdorur një titull.”* Ky ligj, në nenin 8 ka rregulluar bartësit publik të arsimit të lartë, ku në par. 1 ka përcaktuar se: *“1. Bartësit publik të arsimit të lartë janë universitetet dhe institucionet e tjera të arsimit të lartë.”* Neni 10 par. 4 i të njëjtit ligj përcakton se: *“Fjala “Universitet”, si fjalë e ndarë ose në kombinim me përshkrime të tjera, nuk mund të miratohet ose të përdoret në çfarëdo forme në emërtimin e ndonjë bartësi pa lejen e Ministrisë, pas miratimit në parim nga ana e AKA-së.”*

Ndërsa në nenin 11 të po të njëjtit ligj është rregulluar themelimi i bartësve tjerë të arsimit të lartë, ku në par. 1 përcaktohet se: *“Ministria, në pajtim me paragrafin 1. të nenit 8 të këtij*

*ligji, përveç universitetit mund të themelojë edhe bartës të tjerë të arsimit të lartë, të cilët mund të japin diploma, grada dhe tituj që i nënshtrohen akreditimit nga AKA-ja. Ajo mund ta bëjë këtë në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet një partneriteti publik-privat, siç është përcaktuar në nenin 3 të këtij ligji.” dhe në par. 5 përcaktohet se: “5. Bartësit e arsimit të lartë, përveç universiteteve, me kusht të akreditimit sipas nenit 4 të këtij ligji, fitojnë emërtime, të cilat pasqyrojnë natyrën, fushëveprimin dhe nivelin e ofertës të tyre. Sipas këshillës së AKA-së, Ministria do të nxjerrë rregullore për emërtime të tilla, të cilat mund të përfshijnë në mes të tjerash emërtime, siç janë: “kolegj universitar”, “kolegj”, “institut”, “shkollë” ose “akademi”.*

Nga provat Vendim nr.464/12 i datës 09.07.2012 dhe Vendim nr. 515/13 i datës 08.07.2013 gjykata konstaton se paditësi i është nënshtruar procesit të akreditimit në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, andaj në këtë rast, asnjë dispozitë e këtij ligji nuk është zbatuar në mënyrë retroaktive. Pra, vetëm fakti se me vendimet e vitit 2007 paditësi është licencuar si Universitet, të njëjtit nuk i jep të drejtë që të njëjtën licencë ta mbajë në afat të pacaktuar, pasi që edhe vetë licencat e lëshuar gjatë vitit 2007 mbajnë afate të vlefshmërisë. Me rastin e akreditimit sipas Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës paditësi nuk ka pasur asnjë licencë vlefshme për mbajtjen e emërimit “Universitet”.

Gjithashtu, gjykata konstaton se akreditimet dhe licencimet i nënshtrohen procedurave, kushteve dhe kriterëve ligjore që janë në fuqi në momentin e aplikimit ashtu që, aplikimi për akreditim pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës detyrimisht që do të nënshtrohet procedurave, kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj dhe asesi nuk mund ti referohet ligjit paraprak pasi që i njëjti është shfuqizuar.

Po ashtu, gjykata në këtë çështje, nuk ka gjetur asnjë rast të aplikimit të dispozitave ligjore në mënyrë retroaktive nga i padituri lidhur me procedurat e licencimit. Për më tepër me provat e administruara Përgjigje në kërkesë nr.10/1214, dt.15.03.2012 dhe Letër distribuimi nr. 363 dt.24.08.2016, i padituri e ka bërë të qartë se në asnjë rast Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nuk do të ketë fuqi retroaktive ashtu që të gjitha BPrAL të cilët kanë qenë të akredituar dhe licencuar për programet të cilat kanë përgatitur kuadro për mësimdhënie dhe studentët e regjistruar në programet e akredituara dhe licencuara para hyrjes në fuqi të ligjit vazhdojnë deri në përfundimin e studimeve, e po ashtu kanë përcaktuar se diplomat e lëshuara nga BPrAL që licencimin dhe akreditimin e parë e kanë para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, trajtohen të barabartë me të diplomuarit në universitetet publike.

Ndërlidhur me dispozitat ligjore të cituara më lartë dhe gjendjen faktike të konstatuar, gjykata vlerëson se i padituri ka vepruar drejtë kur nuk ka aprovuar kërkesën e paditësit që ti njihet statusi i “universitetit” me të gjitha të drejtat ligjore dhe e drejta e përdorimit të emrit universitet, pasi që Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës ka përcaktuar se vetëm bartësit publik të arsimit të lartë mund të licencohen si Universitete, ndërsa bartësit tjerë të arsimit të lartë mund të licencohen si “kolegj universitar”, “kolegj”, “institut”, “shkollë” ose “akademi” dhe atë pas miratimit - rekomandimit nga Agjencia Kosovare e Akreditimit.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e mos aprovimit të kërkesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.46/22, datë 06.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.